



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me: Priljeno: 16.07.2024		
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
01-052/01-34088		

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Raport nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës për vitin 2024

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton procesverbal nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës për periudhën janar-qershor 2024 i cili është mbajtur me datën 21.06.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 10:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.

Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziata e Udhëzimit administrativ (MAPL) për Administratë të Hapur në komuna.

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.


Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/06/27764.pdf>



Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1.Publikimi në ueb faqe	14 ditë pune	48
2. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	48





Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë 48 pjesëmarrës, prej tyre 10 femra dhe 38 meshkuj.



Takimi i cili është mbajtur **21.06.2024** duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit Komunal ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e komunës njoftojnë për aktivitetet komunale, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhës për të cilën është thirrur takimi, ndërsa të pranishmit mund të bëjnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoi kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe shumë qytetarëve tjerë, mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti pasi ka përshëndetur të pranishmit takimin e filloi duke i njoftuar ata për punën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2024 të qeverisjes lokale ku bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe.

Kryetari Imri Ahmeti në fillim të këtij takimi është shprehur i kënaqur me dinamikën e investimeve kapitale e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit, ku theksoi se aktualisht janë duke u zhvilluar në teren 44 projekte investime vetanake nga komuna dhe projekte të tjera së bashku me partner.

Kryetari Imri Ahmet, ka vazhduar duke thënë se projekte të shumta kapitale janë proces të publikimit, vlersimit dhe lidhjes së kontratave dhe shumë shpejtë do të fillojë implementimi i tyre.

Po ashtu, Kryetari Ahmeti, gjatë takimit me qytetarët lipjanas ka potencuar se të hyrat e përgjithshme vetanake deri në fund të muajit maj ka arritur të realizohet mbi 53.44 % me theks të veçantë ka përmendur të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë që deri më tani është realizuar 42.61% nga planifikimi për vitin 2024.

Një dinamike pozitive ka cekur edhe shpenzimin e buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale ku për këtë periudhë raportuese janë shpenzuar 39% e buxhetit të planifikuar.

Gjatë prezantimit të punëve që janë duke u realizuar në teren Kryetari Ahmeti ka theksuar se këtë vit Komuna e Lipjanit do të rrit numrin e përfutësve të bursave nga 172 në 400 studentë. Po ashtu ai ka cekur se ekzekutivi ka përgaditur propozimin për aprovim nga Kuvendi për seancën e radhës që të votohet për restaurimin e dy shkollave që janë vlerë e trashëgimisë në Lipjan, shkolla e vogël në Banullë dhe ajo në Dobrajë të Madhe.

Kryetari Imri Ahmeti po ashtu ka njoftuar të pranishmit se tani jemi në kohën e hartimit të Kornizës Buxhetore e cila gjatë vitit mund edhe të pesojë ndryshime, qoftë nga rishikimi i buxhetit, qoftë nga redistribimi, qoftë edhe nga tejkalimet e të hyrave, qoftë edhe nga donacionet dhe grantet që marrim gjatë vitit, por që kontributi juaj përmes dëgjimeve buxhetore për KAB që po zhvillohen është i jashtëzakonisht i duhur për lokalitetet dhe venbanimet nga ju vini në mënyrë që t'i zgjedhim bashkarisht problemet e ndryshme kolektive por edhe ti realojmë projektet më prioritare për vendin tuaj.

Më tutje kryetari Imri Ahmeti ka shpalosur edhe disa nga të arriturat e ekzekutivit përgjatë kësaj periudhe raportuese duke theksuar se në vazhdimësi jemi angazhuar që të gjithë qytetarëve lipjanas t'iu ofrojmë kushte dhe shërbime sa më cilësore. Jam i kënaqur me rezultatet e arritura nga Komuna e Lipjanit në zbatim të ligjit dhe transparencës e llogaridhënies, ka bërë që Lipjani të renditet si komuna e parë në nivel vendi në nga KDI.

Kryetari Ahmeti, duke vazhduar me prezantimin e punëve gjatë këtij takimi potencoi se edhe në këtë Komuna e Lipjanit ka marrë opionionin më të mirë të mundshëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit opionionin e pamodifikuar) dhe është viti i 9-të me radhë që Lipjani merr vlerësimin më të mirë të mundshëm në auditim. Ai po ashtu tha se kur jemi të vlerësimet i gëzohemi faktit që Komuna e Lipjanit në pas çdo matje që ju bëhet komunave është në krye të listave në nivel vendi.

Kryetari Ahmeti, foti qytetarët që të jenë sa më bashkëpunues sa më aktiv që nëpërmjet sugjerimeve, vërejtjeve dhe kërkesave të bëhen pjesë e pandashme e ndikimit në përmirësimin e jetës së gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit, në të njëjtën kohë ai i ka falenderuar ata për kontributin e vazhdueshëm që po japin në lokalitet e tyre.

Unë këtu po e përmbylli prezantimin tim duke ju falenderuar juve per porezencen e juaj dhe për të ju dhënë juve mundësinë për të ngritur ju tema e çështje për të cilat keni interesim.

Në të njëjtën kohë ai ka ftuar qytetarët që të jenë sa më bashkëpunues sa më aktiv që nëpërmjet sugjerimeve, vërejtjeve dhe kërkesave të bëhen pjesë e pandashme e ndikimit në përmirësimin e jetës së gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit, në të njëjtën kohë ai i ka falënderuar ata për kontributin e vazhdueshëm që po japin në lokalitet e tyre.

Ndërsa qytetarët u inkuadruan për të bërë pyetje dhe për të kërkuar sqarime nga Kryetari Imri Ahmeti për shumë çështje.

Takimi ka përfundur në ora 11:45

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet/komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)

Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2024	Ka ngritur shqetësimin e tijë që ka te bëje me një shqetësim të banorëve te lagjes tonë rreth asfaltimit të rrugicave ku kemi probleme me pronarin me të cilin e kemi blerë pronën por tani jemi hy në një marrëveshje të negocimit qe te na asfaltohet rrugica jone, ne mënyre qe ne mos ta pengojmë komunën dhe mos te kërkojmë kompensim nga komuna.	Zymer Ahmeti përfaqësues i lagjes e Akllapit	Kryetari Imri Ahmeti: Lagjeja e Akllapit e di qe është në gjendje të keqe ajo pjesë por unë nuk do të hyj në pazar me askënd për t'ia paguar pronën, e kam thënë kushdo që donë me iu asfaltuar rrugica duhet të jep deklaratën me shkrim që nuk kërkon kompensim nga komuna ne e asfaltojmë për ndrysh nuk asfaltojmë rruge private, nëse ju keni arritur marrëveshje ne do ta fusim në buxhet asfaltimin e rrugëve në atë pjesë.	Komenti u pranua Plotësisht:
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2024	tha se ne Gadime janë bere shume punë ku jemi falënderues, por ka nevojë dhe për disa investime te tjera ne fshat si rregullimi i shtratit te lumit, trotuari, ndriçimi publik dhe asfaltimi i rrugicave ne disa lagje.	Mustaf Rexhepi, Gadime Eperme	Kryetari Imri Ahmeti: Në Gadime është punuar dhe po vazhdojnë punimet në disa projekte dhe do të ketë edhe projekte te tjera në vazhdim për ta kompletuar infrastrukturen ashtu siq ishte edhe kërkesa e juaj.	Komenti u pranua Plotësisht:
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2024	tha se e para është dashtë ne si qytetarë me pas me veti nga një kopje se ku do te ketë investime, me i pa se ku janë	Afrim Hjarullahu, Banullë	Kryetari Imri Ahmeti: Kryetari Imri Ahmeti, në Banullë të do bëhet trotuari ne rrugën kryesore për nga ferma e Pulave që ka mbetur në gjysmë, kemi të planifikuar edhe disa	Komenti u pranua Plotësisht:


	projektet. E dyta deshta me pyet a do te përfshihet ne buxhet projektet për urat ne Banulle dhe Shkolla e Vogël fshatit e cila është ne gjendje shume te keqe.		ura nëper fshatra ku është e nevojshme intervenimi i tyre. Po ashtu kemi përgaditur propozim vendimin si ekzekutiv që në seancen e Kuvendit ë votohet për restaurimin e dy shkollave që janë vlerë e trashëgimisë në Lipjan, shkolla e vogël në Banullë dhe ajo në Dobrajë të Madhe.	
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2024	Tha se ka nevoje për investime se pari pe riasfaltimin e rrugës kryesore, pastaj ndriçimi publik, asfaltimi i disa rrugicave dhe disa projekte te tjera qe jen te domosdoshme për banoret e këtij fshati.	Milaim Xhema, Grackë	Kryetari Imri Ahmeti: në Grackë janë berë disa investime dhe disa punë në rregullimin e infrastrukturës dhe do ti planifikojmë edhe asfaltimin e rrugicave dhe do kujdesimi edhe për ndriçimin public.	Komenti u pranua Plotësisht:
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2023	Në fshatin është punuar, por si kërkesë me kryesore të këshillit të fshatit janë gjetja e një zgjidhje për ujë të pijshëm dhe zgjerimi i rrugës Rufc i Ri, Ribar i Vogël.	Nystret Kelmendi, Ribar i Vogël	Kryetari Imri Ahmeti: tha se sa i përket investimeve në ujësjellës ne kemi investuar aty ku ka pas nevojë, ndërsa ne nuk menaxhojmë me ujësjellës por menaxhon kompania e ujësjellësit e cila është e licencuar për këtë punë. Rruga Rufc i Ri, Ribar i Vogel, kanë nevojë	Komenti u pranua Plotësisht:

			për zgjerim dhe do ta bëjmë.	
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2024	Falënderoj kryetarin për investimet që janë bërë në fshatin Shalë, por e kam një kërkesë që të behet rrënimi i objektit të shtëpia e shëndetit që është i rrezikshëm për qytetaret e asaj pjese, si dhe të bëhet rrënimi i shkollës së vjetër në fshatin Risinoc.	Xhyle Korupzi, nga Shala,	Kryetari Imri Ahmeti: ka thënë se do të rrënojmë ato objekte të cilat janë të rrezikshme për qytetaret, Ai po ashtu tha se edhe gjatë viteve në vazhdim banorët e Shalës do të ju gëzohen edhe shumë projekteve të tjera që t'i realizojmë atje.	Komenti u pranua Plotësisht:
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2024	Falënderon komunën për investimet që janë bërë në fshatin Kleqkë, pasi që janë bërë disa punë të mira në fshat dhe jemi falënderues.	Milam Shala, Kleqke	Kryetari Imri Ahmeti: është obligim i yni që qytetarëve të komunës së Lipjanit të ju sigurojmë kushte më të mira për jetë.	Komenti u pranua Plotësisht:
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2024			Kryetari Imri Ahmeti: Po ashtu tha se në Grackë do të kemi parasysh trotuarin se bashku me ndriçim publik për rrugën kryesore. Pastaj tha se së shpejti do të filloj ndërtimi i parkingut për shtëpitë e komuniteteve apo shtëpive të të pamës dhe para xhamive, si dhe zhavorrimi i rrugëve bujqësore.	Komenti u pranua Plotësisht:

--	--	--	--	--

Shtojcë: lista e pjesëmarrësve

Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun


Bukurie Zejnullahu -Jashari

Lipjan, 16.07.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REGJISTRI I PREZENCËS PËR MBLEDHJEN PUBLIKE ME QYTETARË TË KOMUNËS
SË LIPJANIT E MBAJTUR MË 21.06.2024 NË ORA 10:00

Nr. Re.	Emri dhe Mbiemri	Pozicioni	Nënshkrimi
1.	Skender Gashi	Kryetar Fshat	[Signature]
2.	Bleart Pllana	Kryetar Fshati	[Signature]
3.	Syleta Rexhepi	Kryetar Fshat Gash	[Signature]
4.	Lysbet Kelmendi	Kryetar Fshat Pipari	[Signature]
5.	Mila Tim Shela	Riesi	[Signature]
6.	MUHARREM LATIF	KRYTAR LELETIC	[Signature]
7.	ILAZ TEGROCI	KRYETAR BAKABAL	[Signature]
8.	LIRIA DRAGARINA	KRYETAR - BUSAN	[Signature]
9.	Julian Hashan	Rubina	[Signature]
10.	Shahin Shabani	Fotoc	[Signature]
11.	MIRIC JOVICA	LIPJAN I PRESEDNIK	[Signature]
12.	Art Krasniqi	YAHU	[Signature]
13.	Belim Krasniqi	YAHU	[Signature]
14.	DERIN HASRULLAHU	BANULIC	[Signature]
15.	PEPPARIN SHALA	LUGE	[Signature]
16.	NAZMI KRASNIQI	LUGE	[Signature]
17.	BACONIL IBRAHIM	GLOROV	[Signature]
18.	Yngje Krasniqi	K. KILIC, F. SHACI	[Signature]
19.	Ali Sopu	K. KILIC, F. SHACI	[Signature]
20.	Milaim Xhama	K. KILIC, F. SHACI	[Signature]
21.	Ali Imami	K. KILIC, F. SHACI	[Signature]
22.	Mehdi Arushi	Bled (2)	[Signature]
23.	Haki Shala	Kryetar Vrelli	[Signature]
24.	Pranvera Krasniqi	Lipjan	[Signature]
25.	SHAP JAKU	Hilleva	[Signature]
26.	ARDESHA HETEMI	LIPJAN	[Signature]
27.	Qendresa Jasharica	Lipjan	[Signature]
28.	Bukur Zinellahu	Lipjan	[Signature]
29.	Ferdin Shala	Lipjan	[Signature]
30.	Fjeter Ahmeti	Lipjan. Përfyqesues	[Signature]
31.	Lipela Shkupi	Lipjan	[Signature]
32.	Shahin Sopu	Lipjan	[Signature]
33.	Megjita Krasniqi	Lipjan	[Signature]
34.	Farbenda Shabani	Lipjan	[Signature]
35.	FLAMUR SYLEJMANI	DREJTOR I INSPEKTORAT	[Signature]
36.	Scod Beir	Drejtues i Infrastrukturës	[Signature]
37.	Burim Krasniqi	DREJTORI	[Signature]
38.	Kasim Hasan	Koncil	[Signature]

39	BEKIM SHABANI	D. I PROKURIMIT	Eshaburini
40	Valon Pacolli	D. Ekonomik dhe zhvillim	Shqip
41	Amila Legica / Lugini	D. KRS	Shqip
42	Shekron Hajdari	D. SHPS	Shqip
43	Elmaza Belibeli	AD	Shqip
44	Demir Bektas		Shqip
45	Daut Azemi		Shqip
46	Gulaim Berimaj		Shqip
47	Lati Ramadani	DRF	Shqip
48	AVNI JASHARI	HALLAQ IV.	Shqip
49			
50			
51			
52			
53			
54			
55			
56			
57			
58			
59			
60			
61			
62			
63			
64			
65			
66			
67			
68			
69			
70			